



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.786/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesuese, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelet e Milot Deliu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes, Milot Deliu nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime me shenjën ZL.Anr.786 dhe ZL.Anr.787 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Shtime në Vendvotimet: 2201x/02R në Shkollën fillore Emin Duraku, 2209E/02D në shkollën fillore Idriz Ajeti-Pjetërshticë

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar dy apele me datën 09.11.2017, nga Milot Deliu kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Shtime. Në apelet e parashtuara nga ankuesi pretendohet se në vendvotimet: 2201x/02R në Shkollën fillore Emin Duraku dhe 2209E/02D në shkollën fillore Idriz Ajeti - Pjetërshticë ka pasur mospërputhje të numrit të votave të subjektit dhe numrit të votave të kandidatit. Në këto vendvotime për arsye të panjohura nuk janë dërguar në rinumërim, mirëpo është intervenuar vetëm me zvogëlim të votave pa i rinumëruar për dëmtim eventual të kandidatëve me të cilën është dëmtuar edhe ai vet personalisht. Parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimin 2201x/02R në Shkollën Emin

Duraku-Shtime, subjekti politik PDK ka 124 vota, ndërsa kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal kanë 175 vota dhe në vendvotimin 2209E/02D në shkollën Filllore Idriz Ajeti-Pjetërshtic, i njëjti subjekt politik ka 160 vota ndërsa kandidatët për anëtar të kuvendit komunal 234 vota. Në apel kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen këto vendvotime sepse kanë informacione dhe fakte se janë manipuluar votat e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.786/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për dy apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të sigurtë ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të despozitivit.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, nga si u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr. 786/2017 më datën 11.11.2017.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa

Kryesuesja e Panelit

Rafet Haxhaj

